

VENDIM
Nr. 65, datë 6.9.2018

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME KAVAJË

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a., për licencim për efekt përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 10, datë 16.3.2015, “Për licencimin sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë”, të ndryshuar.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë ka aplikuar për licencim pranë ERRU-së, me shkresën nr. 1622 prot., datë 4.6.2018, për efekt të përfundimit të afatit.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, për kategoritë A, B dhe C, konkretisht:

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Për dokumentin “Ekstrakt Historik i Regjistrit Tregtar”, në të cilin ende nuk janë reflektuar ndryshimet sipas riorganizimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a., bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë detyrohet të paraqesë pranë ERRU-së ekstraktin e QKB-së të përditësuar, menjëherë pas përfundimit të procesit.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë ende nuk është pajisur me leje të re mjedisore për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura dhe për këtë arsye nuk mund të licencohet për kategorinë D, “Për trajtimin e ujërave të ndotura”.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë, me:

Drejtues ligjor: Hajrulla Tafa;

Drejtues teknik: Sali Vogli.

2. Operatori Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Sarandë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar, në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria B: Për përpunimin e ujit për konsum publik;

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Kavajë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani